



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot

Datë _____.____.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbim
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Studim-Projektim objekti “Sistemim asfaltim rruga fshati Pacomit” Përmet

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
71335000-5- Studime inxhinierike, 22114311-5 - Projekte

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 565 323,78 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëzet e tre presje shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Përmet AK** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”, si dhe në përputhje me Dokumentet e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr.08, datë 23.09.2024.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, dhe nenin 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 2, germa c) e 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", te Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar pika 4.. në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën si dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës".*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë profesionale të shoqërisë (të vlefshme) sipas rregullores së miratuar me VKM-në nr. 943, datë 28/12/2016 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

d. Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

i. Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

d. Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) – damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.

6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

a. Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

8. PROJEKTUES GJEODET

a. Rivlime inxhinierike.

9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK

e. Studime e projekte hidrogeologjike.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

a. Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

c. Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të

ushetrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Kategoritë e licencës së kërkuara janë në raport të drejtpërdrejtë me natyrën, kompleksitetin dhe komponentët teknikë të objektit të prokurimit dhe janë të nevojshme për realizimin e plotë dhe cilësor të shërbimit të studim-projektimit.

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorisë	Përshkrimi për kategoritë
3. Projektues konstruktor	d.Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.	Projektimi i mureve mbajtës e pritës prej beton arme si dhe i veprave të tjera të artit që do të jenë pjesë e këtij projekti. Projektimi kërkon vlerësimin e kapacitetit mbajtës për strukturat mbajtëse dhe pritëse të rrugës që do të ndërtohen.
4. Projektues instalator	i.Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.	Projektimi i rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugën që shtrihet në brendësi të zonës urbane.
5. Projektues vepra hidraulike	d. Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) – damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.	Projektimi i veprave të kullimit të ujrave të larta dhe ujrave të shiut ku përfshihen kanalet anësore të rrugës, tombinot në prerje tërthore të rrugës dhe në daljet e rrugës për në drejtime të tjera.
6. Projektues rruge - hekurudha	a. Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.	Rruga që kërkohet të projektohet është rrugë lokale e cila shërben për të lidhur një zonë urbane me rrugën nacionale Përmet -Këlcyrë.
8. Projektues gjeodet	a.Rivlime inxhinierike	Bazuar ne detyren e projektimit projektuesi gjeodet do te jete i domosdoshem pasi objekti kërkon rilevim topografik të detajuar të zonave të projektimit, duke përfshirë aksin e kanaleve, profilet gjatësore e tërthore, brigjet, skarpatat, veprat ekzistuese dhe hartimin e planit topografik si bazë për projektimin.
9. Studim gjeologo-inxhinierik – hidrogeologjik	e.Studime e projekte hidrogeologjike	Bazuar ne detyren e projektimit projektuesi gjeolog do te jete i domosdoshem pasi objekti përfshin studime gjeologjike, gjeoteknike dhe hidrogeologjike, investigime

		në terren, vlerësimin e kushteve të terrenit dhe regjimit të ujërave, si dhe analizën e stabilitetit të brigjeve e skarpatave, të domosdoshme për projektimin e veprave hidroteknike dhe mbrojtjes nga përmbytjet.
11. Projektues të sinjalizimit rrugor	a. Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime	Sinjalistika rrugore e shtrire dhe vertikale. Vijeimet, tabelat e indikacionit etj ne rruge lokale. Projekti kërkon parashikimin e vendosjes së sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale me qëllim ruajtjen e sigurisë rrugore dhe qarkullimin normal dhe të sigurt të automjeteve, motomjeteve dhe të këmbësorëve.
12. Studime të sizmologjisë inxhinierike	c. Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.	Ndërtimi i mureve mbajtës e pritës, i veprave të artit, tombinove etj kërkon përcaktimin e kushteve sizmike të zonës me qëllim marrjen në konsideratë të parametrave që duhen në projektimin e tyre.

2.3.3 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë minimalisht **8 (tetë)** punonjës të pasqyruar në listëpagesën e muajit të fundit. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve muajin e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbyshur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “..... *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*”.

Argumentim: Kërkesa është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbyshur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur duke u bazuar në shërbimet e kërkuara sipas detyrës së projektimit. Numri i

punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë listëpagesat e shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave shoqërore dhe shëndetësore me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.4 Operatori/ët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës, duhet të disponojnë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, që të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht si më poshtë:

Stafi kryesor për shërbimin e projektimit

- 1 (një) Projektues Inxhinier ndërtimi i cili duhet të zotërojë licensë 6/a
- 1 (një) Projektues Inxhinier ndërtimi profili strukturist i cili duhet të zotërojë licensë 3/d,
- 1 (një) Projektues Inxhinier Hidroteknik i cili duhet të zotërojë licensë 5/d,
- 1 (një) Projektues Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik i cili duhet të zotërojë licensë 8/a

Për secilin prej projektuesve të lartpërmendur Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin Diplomë, Kontratë pune (të vlefshme), licencë individuale në projektim, CV që pasqyron përvojën e punës si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit. Secili anëtar i stafit teknik të deklaruar duhet të paraqesë një deklaratë disponueshmërie, ku të konfirmojë se është në dispozicion dhe i gatshëm të kryejë shërbimet dhe detyrat profesionale që i janë ngarkuar në kuadër të realizimit të kontratës.

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “..... Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Sipas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 dhe neni 41, pika 4/b , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit

ekonomik për të përmbushur kontratën. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Stafi i mësipërm, do të realizojë projektet sipas kompetencës dhe liçencës bazuar në VKM-në nr.759, datë 12.11.2014 “Për liçencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim” e ndryshuar.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI PËR KATEGORITË
Inxhinier Ndërtimi	Bazuar në detyrën e projektimit, Inxhinieri i Ndërtimit do të jetë specialisti kryesor i hartimit të projektit. Ai do të angazhohet në projektimin e rrugës, llogaritjet e nevojshme për shtresat rrugore dhe elementët e tjerë të nevojshëm të trupit të rrugës sipas standardeve dhe normave teknike në fuqi, së bashku me relacionet teknike.
Inxhinier ndërtimi profili strukturist	Bazuar në detyrën e projektimit, ky inxhinier do të kryejë hartimin e projekteve konstruktive së bashku me relacionet teknike si dhe llogaritjet statike e sizmike të strukturave prej betonarmeje dhe veprave të tjera sipas standardeve dhe normave teknike në fuqi.
Inxhinier Hidroteknik	Bazuar në detyrën e projektimit, Inxhinieri Hidroteknik kërkohet për studimin dhe projektimin e sistemit të kullimit të ujrave në trupin dhe kanalet anësore të rrugës së bashku me relacionet teknike. Gjithashtu do të kryejë dhe llogaritjet hidraulike të veprave të kullimit të ujrave si kanalet kulluese, ura, tombino etj.
Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/ Gjeomatik	Bazuar në detyrën e projektimit, ky inxhinier kërkohet për realizimin e rlevimeve topografike, përcaktimin e koordinatave dhe kuotave të terrenit, hartimin e planeve topografike, piktimitin e rrugës dhe përgatitjen e bazës topografike të nevojshme për zhvillimin e projektit të zbatimit së bashku me relacionet teknike.

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në liçencën e shoqërisë) si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Gjeolog/Hidrogjeolog/Gjeoteknikë i cili duhet të zotërojë liçensë 9/e
- 1 (një) Inxhinier në Infrastrukturë e Transport/Mekanik i cili duhet të zotërojë liçensë 11/a

- 1 (një) Inxhinier Sizmiolog/Gjeofizikë/Gjeolog/Hidrogeolog, i cili duhet të zotërojë liçensë 12/c
- 1 (një) Inxhinier Elektrik i cili duhet të zotërojë liçensë 4/i
- 1 (një) Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për hartimin e raporteve të ndikimit në mjedis.

Për stafin mbështetës duhet të paraqiten kontratat e punës (të vlefshme) ose kontratë angazhimi, diplomat, licencë individuale në projektim, CV dhe Çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për ekspertin e mjedisit. Një punonjës nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “..... Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponimin e stafit mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në liçencën e shoqërisë) për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit mbështetës i është referuar Detyrës së Projektimit.

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI PËR KATEGORITË
Inxhinier Gjeolog/Hidrogeolog/Gjeoteknikë	Bazuar në detyrën e projektimit, ky inxhinier kërkohet për studimin e karakteristikave gjeologjike të zonës, vlerësimin e stabilitetit të terrenit, përcaktimin e parametrave të truallit dhe rekomandimin e zgjidhjeve teknike për ndërtimin e rrugës, elementeve konstruktivë, veprave të artit etj. së bashku me relacionet teknike.
Inxhinier në Infrastrukturë e Transport/Mekanik	Bazuar në detyrën e projektimit, ky inxhinier kërkohet për realizimin e projektit të sinjalistikës rrugore dhe planin e mobilitetit të trafikut rrugor së bashku me relacionet teknike.
Inxhinier Sizmiolog/Gjeofizikë/Gjeolog /Hidrogeolog	Bazuar në detyrën e projektimit, ky inxhinier kërkohet për realizimin e studimit sizmologjik të terrenit në të cilin ndodhet trupi i rrugës si dhe ku do të ndërtohen elementët konstruktivë dhe veprat e artit të rrugës, së bashku me relacionet teknike.
Inxhinier Elektrik	Bazuar në detyrën e projektimit, ky inxhinier kërkohet për projektimin e rrjetit elektrik të ndricimit rrugor të rrugës së bashku me elementët e tjerë të nevojshëm për furnizimin me

	energji elektrike të këtij rrjeti elektrik, sipas standardeve dhe normave teknike në fuqi, së bashku me relacionet teknike,
Ekspert VNM	Bazuar në detyrën e projektimit, Eksperti i VNM kërkohet për hartimin e dokumentacionit mjedisor, vlerësimin e ndikimit në mjedis, identifikimin e masave mbrojtëse gjatë zbatimit të projektit dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme mbi burimet ujore dhe mjedisin përreth.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera mjetet e pajisjet teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes	Njësia	Sasia	Statusi
1	Aparat GPS	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Total Station	copë	1	Në pronësi ose me qera

- a) Për pajisjet e mësipërme, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqese fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore, ose nje dokument tjetër që verteton blerjen e pajisjeve, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë dhe fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore (original ose fotokopje e noterizuar).

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “..... Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Pajisjet e mesiperme nevojiten për marrjen, matjen, grumbullimin e të dhënave në terren.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO sipas formatit të miratuar ku në fushën e certifikimit të jetë parashikuar objekti i prokurimit studim-projektim si më poshtë:

-Certifikatën për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-Certifikatën për menaxhimin e mjedisit ISO 14001:2015 e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- **Çertifikatën për sistemimin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë SSH EN UNI ISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH EN UNI ISO 45001 – 2023) e përditësuar**, e vlefshme/ose/ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- **Çertifikatën për sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor ISO 39001:2012 e përditësuar**, e vlefshme/ose/ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH EN UNI ISO 45001 – 2023) është standard ndërkombëtarë, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 Kjo certifikatë mundëson që kompanitë të punojnë me sistemet e qarkullimit rrugor, të reduktojnë dhe të përjashtojnë rreziqet e humbjes të jetes dhe plagosjeve në lidhje me aksidentet gjatë procesit të punës.

Kostot e projektimit

Tabela e vlerësimit paraprak të kostos:

Nr.	Emri i Projektit	Vlerësimi paraprak i kostos së investimit, në Lekë (pa TVSH)	Kategoria e Tarifave të Shërbimit të projektimit
1	Studim-Projektim objekti “Sistemim asfaltim rruga fshati Pacomit” Përmet	45 816 115,17	Strukturat Transporti, Grupi tarifar II

Shënim: Në vlerën paraprake të kostos së investimit përfshihen punime gërmimi, rafshimi dhe mbushje që sipas përlllogaritjeve paraprake janë:

1	3.161/2	Rrafshim skarpate ne gërmim, ekskavator 0.25m3	m2	1250
2	3.89/a	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	853
3	3.48/b	Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne gërmim toke te zakonshme	m2	1871
4	3.90/a	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne mjet	m3	155
5	3.164/1a	Mbushje me material te gërmuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	811

Në bazë të nenit 41 të VKM-së Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori,projektim,mbikëqyrje dhe kolaudim”, në përlllogaritjen paraprake të fondit limit, zërat e mësipërm janë përlllogaritur në 40 % të vlerës.

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Bazuar në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga njësia e prokurimit.

- U diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe u bë miratimi i dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 01.09.2026, ora 11⁰⁰, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al.**

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit

NJËSIA E PROKURIMIT

MIRATOI
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Alma HOXHA